- a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;
 - b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).
7. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:
- a) çmimet ;
 - b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
 - c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
 - d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.
8. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).
9. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

(Emri dhe Firma e Personit të Autorizuar për Përfaqësim të Ofertuesit)

(Titulli sipas pozicionit në punë) (Data)

Shtojca 2

[Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor në Marrëveshjen Kuadër gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit]

FTESA PËR OFERTË

(shkruani emrin e Autoritetit Kontraktor)

fton për të paraqitur oferta në procedurën për kryerjen e shërbimeve të mëposhtme:

.....
.....
.....

(jepni një përshkrim të saktë të objektit të kontratës dhe sasise siç përkufizohet në Dokumentat e Tenderit (DT).

Vendi i kryerjes së shërbimit

(jepni një përshkrim të shkurtër)

Kohëzgjatja e shërbimit _____

Oferta duhet të paraqitet

.....[

Jep adresën e saktë]

Përpara

.....

[Përcaktoni datën dhe orën përfundimtare]

Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese

Forma e komunikimit:

Me shkrim ____

Elektronik (email, fax etj.) _____

Shtojca 3

[*Letër me logon e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve*]

[*Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik, kur kërkohet nga autoriteti kontraktor*]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

[Data _____]

Për: [*Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor*]

Në emër të: [*Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar*]

Procedura e prokurimit [*lloji i procedurës*]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [*objekti*]

Publikimi (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike [*Data*] [*Numri*]/ Nr.Referencës në faqen e APP-se

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [*emri i ofertuesit të siguruar*] ka derdhur një depozitë pranë [*emri dhe adresa e bankës / kompanisë së sigurimit*] me një vlerë prej [*monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra*] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [*emri i autoritetit kontraktor*] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në

dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës ose ftesën për tender].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti]

LISTA E INFORMACIONIT KONFIDENCIAL

(Shënoni më poshtë informacionin që dëshironi të mbahet konfidencial)

| Lloji, natyra e informacionit që duhet të mbetet konfidencial | Numri i faqes dhe pikat e DT që dëshironi të mbeten konfidenciale | Arsyet pse ky informacion duhet të mbetet konfidencial | Afati kohor që ky informacion të mbetet konfidencial |
|---|---|--|--|
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |

KUJDES

Çdo e dhënë, që nuk është regjistruar si e dhënë konfidenciale, do të konsiderohet se titullari i këtyre të drejtave ka dhënë vetë pëlqimin për dhënien e informacionit përkatës dhe Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për publikimin e këtij informacioni.

Nuk përbën sekret tregtar informacioni, që duhet të bëhet publik në bazë të ligjit, që lidhet me shkeljen e ligjit, apo që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare e parimeve të

etikës tregtare. Përhapja e këtij informacioni vlerësohet e ligjshme, nëse nëpërmjet këtij akti synohet të mbrohet interesi publik.

Shtojca 5

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik*]

DEKLARATË MBI PERMBUSHJEN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik, që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, me cilësinë e _____ të personit juridik _____ deklaroj se:

Përbushim të gjitha specifikimet teknike, të përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe e vërtetojmë këtë me çertifikata e dokumenta (nëse kërkohen nga autoriteti kontraktor), të dorëzuar bashkë me këtë deklaratë.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

V ula

Shtojca 6

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

DEKLARATË **Mbi konfliktin e interesave**

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Konflikti i interesit është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësiive të tij publike.

Në zbatim të nenit 21 pika 1 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve përcaktuar në Kreun III, Seksioni II, që iu ndalohet në mënyrë absolute të përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga lidhja e kontratave me një palë një institucion publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, zvkryeministri, ministrat, ose zvministrat, Deputetet, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët e Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë e në atë të Apelit, Avokati i Popullit, Anëtari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Anëtarët e Enteve Rregullatore, (Këshilli i Mbikqyrjes i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zv/Guvernatorin; të konkurrencës, telekomunikacionit; energjisë; furnizimit me ujë; të sigurimeve; letrave me vlerë; mediave), Sekretarët e Përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar tjetër, në çdo institucion publik, që është të paktën i barazvlefshëm për nga pozicioni me drejtorët e përgjithshëm, titullarët e institucioneve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për zyrtarët e nivelit të mesëm drejtues sipas nenit 31, dhe për zyrtarët e parashikuar në

nenin 32 të kreut të III, seksioni 2 të këtij ligji, ndalimi sipas pikës 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave në fushën e territorit dhe të juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë është një institucion i varësisë.

Kur zyrtari është në funksionin e kryetarit a të nënkryetarit të bashkisë, komunës ose të këshillit të qarkut, të anëtarit të këshillit përkatës ose është zyrtar i nivelit të lartë drejtues të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave privatë të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë, zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave, sipas rastit, me bashkinë, komunën ose këshillin e qarkut, ku zyrtari ushtron këto funksione. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë në kontratë është një institucion publik, në varësi të kësaj njësie (neni 21 pika 2 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e përcaktuara në nenin 21 pika 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin që në kuptim të këtij ligji janë **bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi, fëmijë në moshë madhorë, prindërit e zyrtarit të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es.**

Unë i nënshkruari _____, me cilësinë e përfaqësuesit të personit juridik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:

Jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive si dhe të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Në përputhje me to deklaroj se asnjë zyrtar i përcaktuar në **Kreun III, Seksioni II** të Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk zotëron interesa private në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me personin juridik që unë përfaqësoj.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

Shtojca 7

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik*]

DEKLARATË MBI PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilesinë _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik _____ është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara Nenin 45/1 të LPP.
- Personi/at në cilësinë e *anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik*, si më poshtë:
(emër/atësi/mbiemër)

_____ etj.

nuk janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 45/1 të LPP¹.

- Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- Operatori ekonomik _____ nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).
- Operatori ekonomik _____ ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula _____

Shtojca 7/1

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

DEKLARATË MBI GARANTIMIN E ZBATUESHMËRISË SË DISPOZITAVE LIGJORE NË MARRËDHËNIET E PUNËS

Deklaratë e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____, **deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:**

- Operatori ekonomik _____ garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

LOTI I: “RIPARIM, MIRËMBAJTJEJE SISTEMI TË NGROHJE-FTOHJEVE NË QENDRËN SPITALORE UNIVERSITARE “NËNË TEREZA””

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 7.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet te dorezohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar

zyrtarisht;

b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formulari i Ofertës, sipas Shtojces 1;

b. Deklaratën për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 1/1

c. Sigurimi i ofertes, (nuk kërkohet);

ç. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;

d. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit, sipas Shtojcës 6;

dh. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojces 7/1;

e. Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

3. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

(të plotësohet nga autoriteti kontraktor),

3.1 Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

1. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me **licensë profesionale** që lidhen me realizimin e shërbimeve objekt prokurimit, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, për kategoritë:

➤ **NS12-A** Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit.

➤ **NS-2A** Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre.

2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të shoqërisë, ISO 9001 (e vlefshme). Certifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.

3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë OHSAS 18001 (e vlefshme) ose ISO 45001 (e vlefshme). Certifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.

4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të mjedistit ISO 14001 (e vlefshme). Certifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 74 të VKM-914 datë 29.12.2014, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO sipas zërave të punëve/mallrave/shërbimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas aktmarrëveshjes.

3.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të deklaratave të xhiros vjetore ose vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron e realizuar në tre vitet e fundit nga data e zhvillimit të procedurës, vlera mesatare e të cilës të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit për këtë Lot.
2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: 2016, 2017, 2018, të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore.

3.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit. Këto shërbime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
 - a) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga institucioni shtetëror ose faturat tatimore ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të kryera.
 - b) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të kryera.
2. Operatori ekonomik duhet të ketë jo më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) persona të punësuar, të siguruar për periudhën Shtator 2019 – Nëntor 2019. Për të vërtetuar këtë pikë, operatori ekonomik duhet të paraqesë:
 - Një vërtetim nga administrata tatimore për numrin mesatar të punonjësve për periudhën Shtator 2019 – Nëntor 2019.
 - Listepagesat (E-Sig 025) të konfirmuara nga Administrata Tatimore për periudhën Shtator 2019 – Nëntor 2019.
3. Operatori ekonomik duhet të ketë staf të kualifikuar për drejtimin e punimeve në përberjen e të cilit duhet të jete të paktën:
 - 1 (nje) inxhinier mekanik
 - 1 (nje) inxhinier elektrik

➤ Për punonjësit me profesione si më sipër duhet të paraqesi:

 - *Diplomë*
 - *Kontratë pune*
 - *Libreze pune*
4. Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë të lëshuar nga Administratori i shoqërisë, person përgjegjës për kryerjen e shërbimeve objekt i kësaj marrëveshje kuadër, i cili

duhet të jetë në profesionin **inxhinier elektrik /inxhinier mekanik**, me eksperiencë punë jo më pak se 1(një) vit në këtë profil.

5. Operatori ekonomik duhet të deklaroj se merr përsipër kryerjen e riparimeve dhe shërbimeve mirëmbajtëse në çdo orë gjatë gjithë ditëve kalendarike të përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Operatorët ekonomike që do të ofertojnë për më tepër se një Lot, duhet të kenë kapacitetet ekonomike – financiare (pika 3.2 nënpika 1) e kritereve të veçanta për kualifikim) dhe kapacitetet teknike (pika 3.3 e kritereve të veçanta për kualifikim) sa shuma e loteve, për të cilat kanë ofertuar, të marra së bashku.

Në këtë rast Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku të deklarojnë dokumentet në përmbushje të kritereve komulative për Lotin konkret. Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kritereve komulative nuk plotëson kriteret e vendosura për lotet ku merr pjesë, operatori ekonomik do të skualifikohet tek të gjitha lotet ku ka marrë pjesë.

Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

LOTI II “RIPARIM, MIRËMBAJTJEJE SISTEMI TË NGROHJE-FTOHJEVE NË SPITALIN UNIVERSITAR OBSTETRIK-GJINEKOLOGJIK “KOÇO GLIOZHENI””

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 7.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet te dorezohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formulari i Ofertës, sipas Shtojcës 1;*
- b. *Deklaratën për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 1/1*
- c. *Sigurimi i ofertes, (nuk kërkohet);*
- ç. *Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;*
- d. *Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit, sipas Shtojcës 6;*
- dh. *Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 7/1;*
- e. *Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

3. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

(të plotësohet nga autoriteti kontraktor),

3.1 Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

1. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me **licensë profesionale** që lidhen me realizimin e shërbimeve objekt prokurimit, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, për kategoritë:
 - NS12-A Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit.
 - NS-2A Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre.
2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të shoqërisë, ISO 9001 (e vlefshme). Certifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.
3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë OHSAS 18001 (e vlefshme) ose ISO 45001 (e vlefshme). Certifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.
4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të mjedistit ISO 14001 (e vlefshme). Certifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 74 të VKM-914 datë 29.12.2014, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punëve/mallrave/shërbimeve që do të marr përsipër të realizoj sipas aktmarrëveshjes.

3.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të deklaratave të xhiros vjetore ose vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron e realizuar në tre vitet e fundit nga data e zhvillimit të procedurës, vlera mesatare e të cilës të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit për këtë Lot.
2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: 2016, 2017, 2018, të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore.

3.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit. Këto fshërbime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
 - a) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga institucioni shtetëror ose faturat tatimore ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të kryera.
 - b) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të

paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të e shërbimeve të kryera.

2. Operatori ekonomik duhet të ketë jo më pak se 8 (tetë) persona të punësuar, të siguruar për periudhën Shtator 2019 – Nëntor 2019. Për të vërtetuar këtë pikë, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Një vertetim nga administrata tatimore për numrin mesatar të punonjësve për periudhën Shtator 2019 – Nëntor 2019.
- Listepagesat (E-Sig 025) të konfirmuara nga Administrata Tatimore për periudhën Shtator 2019 – Nëntor 2019.

3. Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë të lëshuar nga Administratori i shoqërisë, person përgjegjës për kryerjen e shërbimeve objekt i kësaj marrëveshje kuadër, i cili duhet të jetë në profesionin **inxhinier elektrik/inxhinier mekanik**, me eksperiencë punë jo më pak se 1(një) vit në këtë profil dhe për të cilin duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- diplomë
- kontrata pune të vlefshme
- librezë pune

4. Operatori ekonomik duhet të deklaroj se merr përsipër kryerjen e riparimeve dhe shërbimeve mirëmbajtëse në çdo orë gjatë gjithë ditëve kalendarike të përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Operatorët ekonomike që do të ofertojnë për më tepër se një Lot, duhet të kenë kapacitetet ekonomike – financiare (pika 3.2 nën-pika 1) e kritereve të veçanta për kualifikim) dhe kapacitetet teknike (pika 3.3 e kritereve të veçanta për kualifikim,) sa shuma e loteve, për të cilat kanë ofertuar, të marra së bashku.

Në këtë rast Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku të deklarojnë dokumentet në përmbushje të kritereve komulative për Lotin konkret. Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kritereve komulative nuk plotëson kriteret e vendosura për lotet ku merr pjesë, operatori ekonomik do të skualifikohet tek të gjitha lotet ku ka marrë pjesë.

Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

LOTI III: “RIPARIM, MIRËMBAJTJEJE SISTEMI TË NGROHJE-FTOHJEVE NË MINISTRINË E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL”

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 7.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi

vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet te dorezohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formulari i Ofertës, sipas Shtojcës 1;*
- b. *Deklaratën për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 1/1*
- c. *Sigurimi i ofertes, (nuk kërkohet);*
- ç. *Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;*
- d. *Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit, sipas Shtojcës 6;*
- dh. *Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 7/1;*
- e. *Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

3. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

3.1 Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

1. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me **licensë profesionale** që lidhen me realizimin e shërbimeve objekt prokurimit, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, për kategoritë:
 - **NS12-A** Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit
 - **NS-2A** Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre.
2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të shoqërisë, ISO 9001 (e vlefshme). Certifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.
3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë OHSAS 18001 (e vlefshme) ose ISO 45001 (e vlefshme). Certifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.
4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të mjedistit ISO 14001 (e vlefshme). Certifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 74 të VKM-914 date 29.12.2014, secili operator ekonomik duhet te dorezoje certifikata ISO sipas zërave te punëve/mallrave/shërbimeve

qe do te marr përsipër te realizoj sipas aktmarrëveshjes.

3.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të deklaratave të xhiros vjetore ose vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron e realizuar në tre vitet e fundit nga data e zhvillimit të procedurës, vlera mesatare e të cilës të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit për këtë Lot.
2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: 2016, 2017, 2018, të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore.

3.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit. Këto fshërbime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
 - a) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga institucioni shtetëror ose faturat tatimore ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të kryera.
 - b) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të kryera.
2. Operatori ekonomik duhet të ketë jo më pak se 7 (shtatë) persona të punësuar, të siguruar për periudhën Shtator 2019 – Nëntor 2019. Për të vërtetuar këtë pikë, operatori ekonomik duhet të paraqesë:
 - Një vërtetim nga administrata tatimore për numrin mesatar të punonjësve për periudhën Shtator 2019 – Nëntor 2019.
 - Listepagesat (E-Sig 025) të konfirmuara nga Administrata Tatimore për periudhën Shtator 2019 – Nëntor 2019.
3. Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë të lëshuar nga Administratori i shoqërisë, person përgjegjës për kryerjen e shërbimeve objekt i kësaj marrëveshje kuadër, i cili duhet të jetë në profesionin **inxhinier elektrik/inxhinier mekanik**, me eksperiencë punë jo më pak se 1(një) vit në këtë profil dhe për të cilin duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - diplome
 - kontrata pune të vlefshme
 - librezë pune
4. Operatori ekonomik duhet të deklarojë se merr përsipër kryerjen e riparimeve dhe shërbimeve mirëmbajtëse në çdo orë gjatë gjithë ditëve kalendarike të përcaktuara në dokumentat e tenderit. Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-

dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Operatorët ekonomike që do të ofertojnë për më tepër se një Lot, duhet të kenë kapacitetet ekonomike – financiare (pika 3.2 nënpika 1) e kritereve të veçanta për kualifikim) dhe kapacitetet teknike (pika 2.3 e kritereve të veçanta për kualifikim) sa shuma e loteve, për të cilat kanë ofertuar, të marra së bashku.

Në këtë rast Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku të deklarohen dokumentet në përmbushje të kritereve komulative për Lotin konkret. Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kritereve komulative nuk plotëson kriteret e vendosura për lotet ku merr pjesë, operatori ekonomik do të skualifikohet tek të gjitha lotet ku ka marrë pjesë.

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

LOTI I “RIPARIM, MIRËMBAJTJEJE SISTEMI TË NGROHJE-FTOHJEVE NË QENDRËN SPITALORE UNIVERSITARE “NËNË TEREZA””

Specifikimet teknike për procedurën e prokurimit me objekt:

“Riparim – Mirëmbajtje e sistemeve të ngrohjes dhe ujit sanitar me kaldaja, sisteme të ngrohjes me chillera, të stacionit të pompave dhe sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm, të elektropompave, në godinat e shërbimeve spitalore të QSUT” për 12

muaj

Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” ka këto sisteme ngrohje, ujë sanitar dhe ujë të pijshëm, që jepen me të gjitha specifikimet e nevojshme teknike në tabelat bashkëngjitur (inventaret e impjanistikës me të dhënat e tyre).

Kaldajat për ngrohje dhe impiantet e ujit sanitar, stacione dhe pompa për ujë të pijshëm, sisteme dhe impiantet uji MNZSH , sisteme te ujit sanitar:

Fuqia dhe marka e kaldajave siç shihet nga tabelat bashkëngjitur, janë të madhësive nga 170 kw në 2.550 kw; sprucatorët janë të tipeve të ndryshme, po kështu edhe kokat e sprucimit të lëndës djegëse janë me përmasa të ndryshme.

Për të gjitha sistemet, lënda djegëse është gasoil dhe kjo kërkon që:

Kokat e sprucatorit 3,5x45 gradë dhe 12x45 gradë, si dhe pompat e presionit të lartë deri në 40 bar, filtërat e lëndës djegëse, si dhe të gjithë pjesët e ndërrimit të kaldajave janë për kaldaja me naftë (gasoil).

Firma mirmbajtëse do të kryejë shërbim, duke zbatuar të gjitha procedurat e nevojshme për këto sisteme, si: auditim (njohje) të sistemeve, shërbime periodike, mirëmbatje sipas grafikut të shoqëruar me urdhëra pune, si dhe zëvendësimin e pjesëve të këmbimit të shoqëruar me urdhëra pune.

Në preventivin e punimeve janë parashikuar edhe zëvendësimi i tubave të tymit prej materiali çelik, rezistent ndaj temperaturave të larta, të një kaldaje ne fuqi 2550 kw, me diametër të brendshëm Ø57 dhe të jashtëm Ø65, me l-2870, copë 70.

Për këtë, duhet të merret parasysh që oxhaku që është i lidhur në mënyrë të ngurtë me kapakun e pasëm të kaldajës, duhet të ç’montohet me prerje dhe të rimontohet. Do të kërkohet gjithashtu:

Kontrolli i jashtëm i gjëndjes së manometrave të presionit, të termostateve, paneleve elektrike të punës dhe komandimit, etj..

Për sistemet e ujit të pijshëm do të kryhen riparimet e kërkuara në preventiv dhe çdo shërbim apo riparim i nevojshëm për funksionim të stacioneve të ujit të pijshëm 24/24 orë. Elektropompat janë të tipeve dhe të fuqive të ndryshme (shih tabelën përkatëse).

Në preventivin e punimeve është parashikuar edhe zëri riparim i defekteve të paparashikuara (të çastit), që duhet kryer me marrjen e njoftimit.

Shërbimet teknike do të kryhen ditë të shtuna e të diela, pa penguar kryerjen e aktivitetit spitalor.

a) Parashikimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” ka katër reparte kaldajash, sisteme furnizimi me ujë sanitar dhe stacion me depo qendrore për ujë të pijshëm si më poshtë:

1. Reparti Qëndror, që ndodhet përballë Spitalit Nr.1 dhe shërben për ngrohjen e Spitalit Nr.1, Spitalit të Kardiokirurgjisë, ujë sanitar për dy godinat e Spitalit Pediatri, Laboratorit Klinik-Biokimik pranë Spitalit Pediatri e Re, Dermatologjisë, Zyrave të Drejtorisë, Zyrave të Farmacisë Qëndrore, Spitalit Djegje-Plastikë, Spitalit Nr. 2 (Kirurgji e Përgjithshme), Spitalit Infektiv, Laboratorit Anatomi-Patologji, Spitalit Onkologjik. Ky repart furnizon me ujë sanitar dy godinat e Pediatrisë dhe Djegje-Plastikës. Në repart janë të instaluar 3

(tre) kaldaja me prodhimtari nxehtësie 2.000.000 k.kalori/orë secila dhe shfrytëzohen në mënyre të alternuar duke qënë në punë vazhdimisht një kaldajë. Lënda djegëse është gazoil, *pra filtërat dhe të gjithë pjesët e ndërrimit të kaldajave janë për kaldaja me naftë.*

2. Reparti i kaldajave të Neurokirurgjisë i cili shërben aktualisht vetëm për sezonin e ngrohjes. Ka të instaluar 2 (dy) kaldaja me prodhimtari nxehtësie respektivisht 1x210.000 dhe 1x450.000 k.kalori/orë. Lënda djegëse është gazoil, *pra filtërat dhe të gjithë pjesët e ndërrimit të kaldajave janë për kaldaja me naftë.* Parashikohet të funksionojë edhe ujë sanitar.
3. Reparti i kaldajave në Neurologji i jep ngrohje edhe Psikiatrisë. Gjatë periudhës tjetër, dërgon ujë sanitar në Neurologji. Ka të instaluar 1 kaldaja me prodhimtari nxehtësie 1x450.000 k.kalori/orë dhe një impiant-shkëmbyes nxehtësie, enë zgjerimi dhe grup elektropompa. Lënda djegëse është gazoil, *pra filtërat dhe të gjithë pjesët e ndërrimit të kaldajave janë për kaldaja me naftë.*
4. Reparti i kaldajave në Spitalin Francez (të specialiteteve) shërben për ngrohje dhe ujë sanitar (në këtë spital nuk ka boliera për ngrohje uji) ka dy kaldaja me prodhimtari nxehtësie 2x450.000 k.kalori/orë. Nga ky repart merr ngrohje Spitalit Francez, Konsultat e Përgjithshme dhe Labororit Immunologjik gjatë sezonit të ngrohjes dhe i jepet ujë sanitar vetëm Spitalit Francez gjithë vitin. Lënda djegëse është gazoil, *pra filtërat dhe të gjithë pjesët e ndërrimit të kaldajave janë për kaldaja me naftë.*
5. Në Shërbimin e Neurokirurgjisë, Djegie-Plastikës dhe në dy godinat e Pediatrisë ka në funksionim këmbyes nxehtësie me aksesoret përkatës (elektropompa, panele komandimi, etj.), që duhet të rivihen në punë për furnizim me ujë sanitar gjatë gjithë vitit.
6. Për furnizim me ujë të pijshëm është në funksionim stacioni qendror me dy depo nëntokësore (të lidhura si enë komunikuese. Në depo ka dy kundralvola Ø 200 mm, për fillimin e punës të elektropompave (thithjen). Vëllimi i depove është 200 mc secila. Janë të instaluar **8 elektropompa 11.5 kw** si dhe saracineskat Ø120 për secilën pompë dhe saracineskat Ø200 për linjate kryesore dhe dy kundralvova Ø 160 në thellësi të depove, që bëjnë të mundur vënien e pompave në punë (copë 26 gjithësej).
Për furnizimin me ujë të godinave të Shërbimit të Pediatrisë, Kardiokirurgjisë, Neurokirurgjisë, Neurologjisë dhe Psikiatrisë ka grupe depozitash, dhe furnizimi me ujë bëhet me elektropompa me fuqi nga 2,2 deri 7.5 kw.
Për Spitalin 6-katësh (Spitali Nr.1) shërben një elektropompë 7,5 kw, për Onkologjikun– 1 elektropompë 5.5 kw dhe për Infektivin – 1 elektropompë 5.5 kw.
Gadishmëria e elektropomave kërkohet 24 orë në 24 orë, dhe gjatë gjithë ditëve të vitit.

b) Grafiku i Lëvrimit

Mirëmbajtja dhe riparimet janë me karakter mekanik dhe elektrik, për linja dhe panele

komandimi.

Shërbimet teknike dhe riparimet **do të kryhen sipas “urdhërave të punës”** të shoqëruar me preventivin përkatës, për të cilat çmimet do të merren nga kontrata dhe do lëshohen nga Sektori Teknik, i cili ndjek dhe zbatimin e tyre në kohë e cilësi.

Shërbimet periodike (teknike) dhe riparimet do të kryhen pa penguar aktivitetin spitalor. Riparimet për defektet e çastit duhet të kryhen menjëherë me marrjen e njoftimit.

Në repartin e ngrohjes qendrore të qendrës teknike qendrore, (pranë kolektorëve kryesor të ujit të nxehtë) do të zëvendësohen tubat e tymit sipas kërkesave të preventivit, brenda afatit 01 Shtator 2020.

Sipërmarrësi do të ketë përfaqësuesin e tij në QSUT (Sektorin Teknik), për të marrë dhe zbatuar detyrat ditore për riparime dhe mirëmbajtje.

Operatori ekonomik duhet të njihet me këto sisteme, gjëndjen e tyre teknike dhe të deklarojë se merr përsipër riparim-mirëmbajtjen e tyre, sipas specifikimeve teknike dhe sipas kushteve spitalore. Njohja e gjëndjes dhe kërkesave spitalore bën që operatori ekonomik të jetë real në paraqitjen e ofertës teknike.

Sistemi i ngrohjes – ftohjes me chiller dhe kaldajë, prodhimit të ujit sanitar dhe avullit, sistemi ventilim – kondicionimit dhe trajtimit të ajrit në Spitalin e Ri.

Spitali i Ri, ka një Qendër Teknike (Godina B), ku janë instaluar sistemet qendrore të ngrohjes, të ujit të ngrohtë, të avullit për sterilizim, kondicionimit, oksigjenit, protoksid azotit dhe kabina elektrike 20/0.4 kV e përbërë nga 3 trasformatorë me fuqi 1000 kwh.

Sistemi i Ngrhjes dhe Ftohjes, janë projektuar dhe zbatuar me impiante qendrore të instaluar në ndërtesën teknike, po kështu funksionojnë edhe kaldajat e prodhimit të ujit sanitar dhe të avullit.

Në këtë sistem ndodhen këto paisje:

1. Kaldajë ngrohje me prodhim nxehtësie max/min 1535/2,360 kE, copë 1(një).
2. Kaldajë ngrohje me prodhim nxehtësie max/min 820/540 kE, copë 1(një).
3. Gjeneratori indirekt i avullit, që shërben për sistemin e kondicionim dhe ventilimit.
4. Çillera me ajër të ftohtë me shpejtësi të variushme, kapaciteti ftohës 103, EER 3.02, Refroxhant R=134 A, Fuqi 348 kE, copë 3 (tre).
5. Paisja qendrore e kondicionimit të ajrit është instaluar me ajër dhe me ujë.
6. Sistemi i ujit sanitar i përbërë nga një sistem pompash, këmbyesish nxehtësie 2 x 5000 litra dhe paisjesh kontrolluese dhe matëse.
7. Sistemi i furnizimit me ujë të paisjeve të MNZSH, është i përbërë nga një sistem pompash dhe motogjeneratorësh, që furnizojnë me energji elektrike sistemin e pompave të MNZSH, në rast ndërprerje të energjisë elektrike.
8. Sistemi i depozitave nëntokësore të furnizimit me karburant 40 m³ secila, dhe janë të

instaluara 3 pompa dërgimi lënde djegëse në depozitën ditore 5.000 litërshe, në repartin e kaldajave.

Mirëmbajtja e këtyre sistemeve kërkon kryerjen e shërbimeve teknike dhe të riparimeve të çastit (emergjente) si më poshtë :

Mirëmbajtja dhe riparimet e sistemeve të ftohje-ngrohjes, të prodhimit të ujit sanitar, avullit dhe paisjeve të MNZSH, kryhen sipas preventivit pjesë përbërëse e kontratës.

Gjatë zbatimit riparim-mirëmbajtja kryhet me “Urdhëra Pune“, të lëshuar nga specialistët përkatës të Sektorit Teknik të QSUT, dhe në përfundim të shërbimeve teknike apo riparimeve hartohet proces verbal i marrjes në dorëzim ku nënshkruajnë të dy palët.

Duhet të sigurohet gadishmëri teknike dhe shfrytëzimi 24/24 orë, dhe me temperaturë të brendshme 20 - 22 °C.

“Urdhëri i Punës“ për riparime të defekteve të çastit shoqërohet me preventiv të hartuar nga përfaqësuesi i QSUT-së dhe nënshkruhet edhe nga Sipërmarrësi, i cili merr përsipër zbatimin në afat e me cilësi të detyrave të dhëna në „Urdhërin e Punës“.

Preventivi përmban njësinë, sasinë, çmimin, vlerën dhe kohën e kryerjes së riparimit të defekteve; çmimet merren nga oferta fituese, që është pjesë përbërëse e kontratës.

Kontroll dhe shërbim periodik mujor jepen në urdhërin e punës nga përfaqësuesi i QSUT-së dhe përfshihen:

- Pastrimi dhe mirëmbajtje filtrash çdo 20 (njëzet) ditë,
- Zëvendësimi i filtërave të dëmtuar (sipas specifikimeve teknike)
- Pastrimi brënda dhe jashtë e baterive të shkëmbimit nxehtësisë çdo 30 (tridhjetë)ditë,
- Kontrolli i presionit dhe plotësimi i sasisë së gazit freon çdo 15 (pesëmbëdhjetë) ditë,
- Kontrolli dhe plotësimi i vajit;
- Kontrolli, larje-pastrimi i serpentinave dhe aksesoreve të tjerë çdo muaj, çdo 30 (tridhjetë)ditë ;
- Kontrolli i funksionimit të kompresorëve çdo 15 (pesëmbëdhjetë) ditë;
- Kontrolli, pastrimi dhe shërbimi i aspiratorëve (elikave) çdo 15 (pesëmbëdhjetë) ditë për eliminimin, disbalancimi gjatë punës;
- Kontrolli, shërbimi dhe pastrimi i fryrësave fancoil tavanor dhe të dyshemesë çdo 15(pesëmbëdhjetë) ditë (godina eshte e tipit bunker dhe sistemi i ajrit merr rëndësi të vecantë);
- Kontrolli dhe mirëmbajtja e paisjeve elektrike të punës dhe të mbrojtjes (salva-vita);
- Kontrolli dhe mirëmbajtje e tokëzimit të motorëve elektrikë;
- Kryerjen e çdo kontrolli dhe shërbimi tjetër mirëmbajtës, të nevojshëm për funksionimin normal të impianteve;

Shërbimet dhe riparimet që do të kryhen, janë të përshkruara në preventivat bashkëngjitur, Riparimet e çastit duhet të kryhen menjëherë, me marrjen e njoftimit.

